

## LËVIZËS ELEKTRONIK: MIRË SE VJEN NAGARES!

Menjëherë në gamën MAHLE Aftermarket

Zgjidhje për elektronikën e automjetit

E RE



## DY EKIPE TË SHKËLQYERA: MAHLE DHE NAGARES

Me rreth 77 000 punonjës, MAHLE është e pranishme në tregjet botërore. Në 16 qendra të mëdha zhvillimi, në Gjermani, Britaninë e Madhe, Luksemburg, Spanjë, Slloveni, SHBA, Brazil, Japoni, Kinë dhe Indi, 6000 inxhinierë dhe teknikë MAHLE po punojnë në produkte dhe koncepte për lëvizshmërinë e së nesërmes.

Si partner global zhvillimi i industrisë ndërkombëtare të automobilave dhe motorëve, MAHLE angazhohet për zgjidhje novatore dhe efikase në fushat e sistemeve të motorëve, filtrimit, menaxhimit termik dhe elektrikës/mekatronikës.



Specialisti spanjoll i elektronikës Nagares zhvillon dhe prodhon elektronikë kontrolli dhe fuqie për agregate elektrike ndihmese, sisteme të menaxhimit termik dhe për e-mobilitetin. Gama përfshin produktet e mëposhtme:

- **Aktuatorë dhe çelësa**
- **Produkte elektronike të tilla si kandela dizel dhe pajisje kontrolli motori Nidervolt, rregullues sinjali paralajmërues akustikë ose elektronikë e veçimit të baterisë**
- **Elektronikë e performancës së lartë si p.sh. konvertere DC/DC**
- **Sensorë të ndryshëm**



E themeluar në 1971, sot, në tre vende (Motilla del Palancar, Valencia dhe Valladolid) Nagares punëson rreth 460 punonjës – dymbëdhjetë për qind prej tyre punojnë në fushat e kërkimit dhe zhvillimit.



MAHLE dhe Nagares nuk kanë vetëm klientë identikë – të dyja kompanitë angazhohen edhe për zgjidhje novatore të lëvizshmërisë dhe shërbime të shkëlqyera për sa i përket cilësisë dhe shërbimit.

#### PERFORMANCË E LARTË PËR TË GJITHA KONCEPTET E LËVIZSHMËRISË

Produktet e të dyja kompanive plotësojnë njëri-tjetrin në mënyrë ideale. Ka kohë që Nagares furnizon fusha të ndryshme biznesi MAHLE me elektronikë kontrolli dhe fuqie. Që nga maji 2017, specialisti i elektronikës bën pjesën në Grupin MAHLE dhe është integruar në sektorin e mekatronikës si fusha e produktit BXE.

Në të ardhmen, biznesi i pjesëve të këmbimit i MAHLE Nagares do të përfshihet nën markën MAHLE si pjesë e fushës së biznesit MAHLE Aftermarket. Në këtë mënyrë, komponentët novatorë elektronikë të MAHLE Nagares do përfitojnë nga imazhi dhe nga rrjeti i shpërndarjes i zhvilluar mirë i MAHLE, një markë cilësie e njohur në mbarë botën.



#### KU SHKRUAN MAHLE NGA JASHTË EDHE NGA BRENDA KA ELEKTRONIKË TË AUTOMJETIT





Më vonë, dizajni i paketimit të produkteve MAHLE Nagares do të ndryshojë. Gjatë fazës së tranzicionit, paketimet mbajnë një etiketë me numrin e artikullit MAHLE.



#### KJO QËNDRON: KU SHKRUAN MAHLE NGA JASHTË, EDHE NGA BRENDA KA CILËSI TË PAJISJEVE ORIGINALE

Si rregull, anëtarët e familjes kanë të njëjtin mbiemër. Prandaj, produktet e MAHLE Nagares do të marrin emra të rinj. Në këtë mënyrë, që në pamje të parë do të jetë e qartë: pas emrit qëndron cilësia e lartë e produktit nga MAHLE Aftermarket.

Kombinimet e shkronjave qëndrojnë për artikujt e mëposhtëm:

Kategoria e produktit	Grupi i produktit	Emri i produktit	Emërtimi i shitjeve MAHLE
 <b>Aktuatorë dhe çelësa</b>	Çelësa/ Rele/ Bobina/ Llamba/ Konektorë/ Kronometër	Llamba	MFL
		Konektorë	MRC
		Kronometër	MT
		Çelës elektrikë	MR
 <b>Elektronikë</b>	Pajisje kontrolli radiatori Pajisje kontrolli për sinjale paralajmërues akustikë Pajisje kontrolli për motorin Elektronika e veçimit të baterisë Elektronikë tjetër	Pajisje kontrolli e kandelave dizel	MHG
		Pajisje paralajmëruese Bori elektronike	MEWD
		Pajisje kontrolli motori Niedervolt	MWH
		Elektronika e veçimit të baterisë	MELM
		Elektronikë tjetër	MB
 <b>Sensorët</b>		Njësi elektronike	MECU
		Sensor temperature	MST
		Sensor kollodoku	MSC
		Sensor uji	MSW
		Sensorë të tjerë	MSO
 <b>Elektronikë me performancë të lartë</b>		Konvertues/ Transformator - DC/DC	MPD



Vlerë më e madhe e shtuar për tregtinë dhe ofiçinat:

- Rrjet global MAHLE me kontakt personal në terren
- Një gamë produkti edhe më e madhe nga një burim i vetëm – për të gjitha lëvizjet e lëvizshmërisë
- Mbështetje teknike gjithëpërfshirëse nga specialistët e produktit MAHLE Aftermarket
- Transferim ekspertize në seancat e trajnimit të produktit MAHLE Aftermarket

Edhe më shumë përfitime:

- Elektronikë kontrolli dhe fuqije për makina dhe automjete komerciale në cilësi të pajisjeve origjinale pa kompromis të MAHLE Nagares
- Kompetencë shumëvjeçare në zhvillimin dhe prodhimin e elektronikës së automjeteve në sektorin e ri të produktit Electronics
- Akses në gamën e zgjeruar të produktit, që tani përfshin zbatime të elektronikës dhe që përputhet vazhdimisht sipas kërkesave të tregut

**MAHLE Aftermarket GmbH**

**Pragstraße 26 – 46**

**70376 Stuttgart**

**Telefon: +49 711 501-0**

[www.mahle-aftermarket.com](http://www.mahle-aftermarket.com)

[www.mpulse.mahle.com](http://www.mpulse.mahle.com)